




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 161/2021
Datë: 7 qershor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të Amandamentit nr. 25 nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7, 8, 9 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 7 dhe 10 të Rregullores nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret e Zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga Gjyqësori, në takimin e 256 –të, të mbajtur me datë 7 qershor 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet pika I e Vendimi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK.nr.139/2021 i datës 26 maj 2021, sa i përket përbërjes së Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të nominimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit nga Gjykata Themelore në Gjakovë.
- II. Në vend të anëtarit të Komisionit z. Cerim Fazliji, për anëtarë të Komisionit për Gjykatën Themelore në Gjakovë caktohet z. Nenad Lazic, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 7 qershor 2021, në bazë të kërkesës për shkaqe shëndetësore të z. Cerim Fazliji, ka bërë ndryshimin e vendimit KGJK.nr.139/2021 të datës 26 maj 2021, në pikën I të dispozitivit, me ç'rast në vend të z. Fazliji, për anëtarë të Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të nominimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit nga Gjykata Themelore në Gjakovë, është caktuar z. Nenad Lazic, anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.

